

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Qershor 2013

Rezultatet Financiare

Aktivitet e ProCredit Bank në total pësuan një ulje prej 2.6% duke arritur në vlerën 280 milion Euro në gjysmën e dytë të vitit fiskal 2013. Kjo ulje lidhet ngushtë me reduktimin e fondeve të konsumatorëve, e cila bazohet në një vendim strategjik që synonte arritjen e rezultateve më të mira financiare.

Baza e depozitave të bankës u ul me 1.4% duke arritur në total në 225 milion Euro. Brenda portofolit të depozitave, pati një zhvendosje nga depozitat me afat drejt llogarive të kursimit dhe një ulje të llogarive rrjedhëse të bizneseve. Në të njëjtën kohë, portofoli i kredive u rrit me 1.7% krahasuar me vitin 2012, duke arritur në 175 milion Euro dhe tregoi rritje pozitive sidomos në muajt prill dhe maj, duke arritur e duke tejkaluar lehtë shifrat e parashikuara (financiare) të buxhetit.

Të ardhurat nga interesat u ulën, kryesisht për shkak të reduktimit të fondeve të disponueshme për investime në instrumente financiare, uljes së çmimeve të tregut në Bono Thesari (me 0.6% në tremujorin e fundit), si edhe për shkak të ndryshimeve në strukturën e portofolit të kredive sa i përket kategorive të klientëve. Megjithatë, kjo u kompensua më shumë nga kontraktimi i fondeve të klientëve dhe rrjedhimisht ulja e shpenzimeve për interesa.

Fondi i mbulimit të cenimit të kredive dhe avancave të klientëve u rrit me 2.3 milion Euro krahasuar me fundin e vitit 2012, për shkak të normës më të lartë të mbulimit me provigjone për kredi që janë në vonesë më shumë se 30 ditë.

Vendosja e prioritetit tek optimizimi i koston dhe rritjes së efikasitetit, ndihmoi në reduktimin e shpenzimeve operative me pothuajse 10%, duke çuar në një përmirësim të përgjithshëm të raportit kosto-të ardhura prej 75.4%, nga 77% që ishte një vit më parë.

Menaxhimi i Rrezikut

Bordi Drejtuesve është organi që mban në përgjegjësinë përfundimtare për zhvillimin dhe vënien në zbatim të strukturave dhe mekanizmave të duhur për identifikimin, vlerësimin dhe zbutjen e ekspozimit të bankës ndaj çdo lloj rreziku. Bordi i Drejtuesve ka ngritur Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut, i cili është i ngarkuar me monitorimin e gjithë gamës së rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet banka. Përveç kësaj, Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut ka edhe autoritetin e vendimmarrjes në lidhje me rrezikun.

Në ProCredit Bank Shqipëri, rreziku matet dhe raportohet sipas politikave të menaxhimit të rrezikut, të miratuara nga Bordi Drejtues. Këto politika janë në përputhje të plotë me rregulloret në fuqi në Shqipëri dhe me kërkesat e vendosura nga Banka e Shqipërisë. Politikat mbështeten në Udhëzuesin e Grupit për Menaxhimin dhe Kontrollin e Rrezikut, i cili, nga ana e tij, bazohet në dokumentin udhëzues të Autoritetit Mbikëqyrës Financiar Federal Gjerman "Kërkesat Minimale për Menaxhimin e Rrezikut". ProCredit Bank Shqipëri raporton sistematikisht në Komitetin e

Menaxhimit të Rrezikut të Grupit (GRMC) lidhur me pozicionimin e saj ndaj rreziqeve të ndryshme.

Kultura e ProCredit Bank për transparencë brenda dhe jashtë bankës është vendimtare për përpjekjet tona të menaxhimit të rrezikut. Falë procedurave tona të përkufizuara qartë dhe inkurajimit tonë për një komunikim të hapur, punonjësit tanë të mirë trajnuar janë në gjendje të identifikojnë rreziqet dhe të marrin hapat e nevojshëm për zbutjen e tyre.

Menaxhimi i Rrezikut të Kredive

Dhënia kredi bizneseve të vogla përbën operacionin kryesor të ProCredit Bank sa i përket aktiveve të saj dhe, rrjedhimisht, edhe rrezikun klasik që lidhet me kreditë, d.m.th. risku që huamarrësit mund të mos jenë në gjendje të shlyejnë kredinë, është risku më i rëndësishëm me të cilin përballet banka. Risku i kredive përbën pjesën më të madhe të rrezikut në kontekstin e llogaritjes së kapacitetit për përbalimin e rrezikut.

ProCredit Bank Shqipëri ka miratuar politika për rrezikun e kredive bazuar në Politikën e Menaxhimit të Rrezikut të Kredive të Grupit ProCredit dhe në Politikën e Grupit për Vlerësimin e Kolateralit, të cilat, së bashku pasqyrojnë përvojën e fituar gjatë më shumë se dy dekadave operacionesh të suksesshme huadhënieje në ekonominë në zhvillim dhe në tranzicion dhe janë në përputhje të plotë me rregulloret në fuqi në Shqipëri. Për çdo klient të bankës, vendoset një kufi për ekspozimin ndaj rrezikut dhe përcaktohet qartë autoriteti që merr vendime në lidhje me kreditë; të gjitha vendimet për dhënien e një kredie apo për ndryshimin e kushteve të saj merren nga një komitet kredish dhe të gjitha vlerësimet e rrezikut të kredisë dokumentohen me kujdes.

Mbi të gjitha, banka përpiqet të ndërtojë dhe të ruajë marrëdhënie afatgjata me klientët e saj, duke u kujdesur që të jetë plotësisht në dijeni të situatës së tyre financiare dhe të mos i ngarkojë ata me më shumë borxhe sesa kanë mundësi të paguajnë.

Rreziku i kredisë zbutet edhe nga fakti që portofoli ynë është tejet i larmishëm. Bizneset, të cilave ne u shërbejmë, operojnë në një gamë të gjerë sektorësh dhe ekspozimi i tyre ndaj luhatjeve globale të tregut është i kufizuar. Përveç kësaj, shumica e ekspozimeve të kredive tona është relativisht e vogël.

Duke qenë se pjesa më e madhe e kredive që jep banka jonë paguhet me këste mujore, mosrespektimi nga ana e një klienti të afatit të shlyerjes trajtohet si një shenjë e parë e një problemi të mundshëm mos shlyerjeje dhe me një reagim të menjëhershëm nga banka. Kur shlyerja e interesit apo kryegjësë nuk paguhet edhe pas më shumë se 30 ditësh pas afatit, kredia në fjalë i ngarkohet portofolit të rrezikuar (kreditë në vonesë më shumë se 30 ditë), gjë që shërben si një tregues kyç për cilësinë e portofolit të kredive dhe për matjen e rrezikut klasik të kredive.

Në gjysmën e parë të vitit fiskal 2013, kreditë në vonesë më shumë se 90 ditë u rritën nga 8.4% në fillim të vitit në 11.9% në Qershor 2013, veçanërisht ndërkohë që ndikimi i vazhdueshëm i krizës financiare po ndihej ende. Një nga mënyrat se si ProCredit Bank ka kapërcyer sfidën e cilësisë së portofolit shkaktuar nga kriza financiare është ofrimi i ristrukturimit të kredive atyre klientëve që vlerësohen se e kanë potencialin për të rifituar stabilitet. Ristrukturimi vjen pas një analize të plotë e të hollësishme të kapacitetit të ndryshuar të shlyerjes të çdo klienti.

Vendimi për ristrukturimin e një kredie të ekspozuar ndaj rrezikut merret gjithmonë nga një komitet kredie dhe ka për synim rikuperimin e plotë. ProCredit Bank Shqipëria ka një qasje konservatore për sigurimin e provigjioneve për kreditë e humbura. Janë vënë në dispozicion disa fonde për kredi individuale të konsiderueshme që konsiderohen të ekspozuara ndaj rrezikut bazuar në rezultatet e një vlerësimi të prekjes së tyre nga ky rrezik, kurse provigjionet për kreditë e

pacenuara, që nuk janë të konsiderueshme individualisht, këto fonde janë llogaritur sipas normës historike të mos shlyerjes (*default*). Për të gjitha kreditë që nuk janë ekspozuar ndaj ndonjë rreziku, janë parashikuar fonde mbulimi të bazuara në portofol. Në fund të Qershorit 2013, raporti i mbulimit (provigjionet për kreditë e humbura sipas Metodologjisë së Bankës së Shqipërisë si një përqindje e kredive në vonesë më shumë se 30 ditë) qëndronte në nivelin e 80.9%.

Kreditë që konsiderohen të parikuperueshme nxirren vazhdimisht jashtë bilancit, fshihen (*written off*). Megjithatë, përpjekjet rikuperuese vazhdojnë edhe pasi kredia hiqet nga bilanci si kredi e pakthyeshme, dhe mbledhja e kolateralit ndiqet me rigorozitet.

Në parim, ProCredit Bank pranon të gjitha llojet e kolateralit. Kolaterali shërben si një garanci që banka, si kredituese, të mund të rikuperojë një kredi të ekspozuar ndaj rrezikut dhe si një mjet për ta motivuar huamarrësin që ta shlyejë kredinë. Vlerësimi i kolateralit bëhet sipas Politikës së Grupit për Vlerësimin e Kolateralit, e cila reflekton përvojën e fituar në më shumë se dy dekada operacionesh të suksesshme huadhënieje, dhe është në përputhje me Standardet Europiane të Vlerësimit të Kolateralit.

Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit afatshkurtër është risku që banka të mos jetë më në gjendje të përmbushë, në mënyrë të pjesshme apo të plotë, detyrimet e saj aktuale dhe të ardhshme të pagesave. Për këtë arsye, banka duhet që të ruajë në çdo kohë fonde të mjaftueshme likuide të disponueshme për përmbushjen e detyrimeve të saj, madje edhe në kohë stresi. Faktorë të ndryshëm që janë pjesë e natyrshme e modelit të biznesit të bankës kompensojnë rrezikun e likuiditetit. Së pari, portofoli i diversifikuar dhe tejet cilësor i bankës do të thotë që fluksi i parasë në hyrje është shumë i parashikueshëm. Së dyti, depozitat e klientëve tanë janë të shpërndara në një numër të madh depozituesish, ku secili ka sasi relativisht të vogla.

Për të përcaktuar fuqinë e likuiditetit të bankës përballë një shoku të mundshëm, banka kryen rregullisht teste stresi të bazuara në skenarë të përcaktuar si standarde në nivel grupi nga Politika e Grupit për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit. Prezumimet në të cilat mbështeten testet e stresit ndryshohen dhe përshtaten për të reflektuar kushtet e tregut. Sa herë që është e nevojshme të kompensojë mungesat në likuiditet, ProCredit Bank Shqipëria, ashtu sikurse edhe bankat e tjera të Grupit ProCredit, ka mundësi që të marrë financime afatshkurtra nga ProCredit Holding.

Menaxhimi i Rrezikut të Këmbimit Valutor

Rreziku i këmbimit valutor përkufizohet si rreziku i pasojave negative mbi rezultatet financiare dhe mjaftueshmërinë e kapitalit të bankës shkaktuar nga ndryshimet në kursin e këmbimit. ProCredit Bank Shqipëria ka një nivel të ulët ekspozimi ndaj rrezikut të këmbimit valutor, pasi ajo nuk hyn në pozicione spekuluese këmbimi valutor dhe as nuk angazhohet në transaksione që rrjedhin prej tyre. Rreziku që lidhet me këmbimin valutor menaxhohet në përputhje me Politikën e Menaxhimit të Rrezikut të Këmbimit Valutor dhe rregulloreve të Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut të këmbimit valutor në librin e bankës. Banka monitoron rregullisht lëvizjet e kursit të këmbimit dhe tregjet e këmbimit valutor dhe e menaxhon pozicionin e saj mbi baza ditore. Për të vlerësuar ndikimin e lëvizjeve të kurseve të këmbimit në pozicionet e hapura të monedhave (OCP), banka zhvillon teste stresi për çdo monedhë të rëndësishme me të cilën ajo operon.

Menaxhimi i Rrezikut të Normës së Interesit

Rreziku i normës së interesit ka të bëjë me ndikimin negativ që lëvizjet në normat e interesit në treg mund të kenë mbi vlerat ekonomike të bankës dhe mbi fitimet e saj nga interesat, e në fund mbi vetë kapitalin e saj. Rreziku i normës së interesit menaxhohet në përputhje me Politikën për Menaxhimin e Rrezikut të Normës së Interesit dhe udhëzimet e Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës. Gjatë vitit 2013, normat e interesit kanë shfaqur një tendencë uljeje graduale. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit matet përmes analizimit të boshllëqeve të maturisë. Për të matur dhe për të analizuar ndikimin e luhatjeve të normës së interesit në vlerat ekonomike dhe të ardhurat nga interesat përdoren testet e stresit. Si masë për zbutjen e rrezikut të normës së interesit, ProCredit Bank ndjek si politikë tërheqjen e financimit afatgjatë me norma fikse dhe ofron kredi me norma të ndryshueshme interesi, duke i dhënë mundësi bankës që t'i rrisë (apo ulë) këto norma, duke iu përshtatur luhatjeve të normave të interesit në treg.

Menaxhimi i Rrezikut Operacional dhe Mashtrimit

Rreziku operacional përkufizohet si rreziku i humbjes që vjen si rezultat i proceseve të brendshme të papërshtatshme ose të pakryera, nga njerëzit dhe sistemet, apo edhe nga ngjarje të jashtme. Ky përkufizim përfshin si rrezikun ligjor, ashtu edhe atë që lidhet me reputacionin e bankës. Politika e rrezikut operacional e ProCredit Bank Shqipëri është në përputhje të plotë me rregulloret e Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut operacional, me Politikën e Rrezikut Operacional të Grupit, si dhe me Politikën e Grupit për Parandalimin e Mashtrimit. Për të minimizuar rrezikun operacional dhe rrezikun e mashtrimit, të gjitha proceset dokumentohen me saktësi dhe u nënshtrohen mekanizmave efikasë të kontrollit. Përshkrimet e punëve janë të plota, detyrat janë të ndara në mënyrë strikte dhe është shmangur varësia nga individë kyç. Gjatë rekrutimit, banka i kushton vëmendje të veçantë integritetit personal, një cilësi që përforcohet përmes zbatimit strikt të kodit të sjelljes së bankës dhe përmes programeve gjithëpërfshirëse të trajnimit të hartuara për të promovuar një kulturë transparence dhe ndërgjegjësimi për rrezikun.

Çështjet e rrezikut operacional rishikohen nga Komiteti i Rrezikut Operacional, i cili është një nënkomitet i Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut, i cili, gjithashtu, drejtohet nga një anëtar i Bordit Drejtues. Ai ka për qëllim të përcaktojë politika për rreziqet që lidhen me njerëzit, rreziqet që lidhen me proceset, rreziqet që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe sistemet, rreziqet e jashtme dhe aspekte të tjera të rrezikut operacional, si dhe të monitorojë respektimin e këtyre politikave. Ai, gjithashtu, diskuton edhe hedhjen e të dhënave të rëndësishme në Bazën e të Dhënave të bankës për Ngjarjet e Rrezikut.

Baza e të dhënave të të gjithë grupit për Ngjarjet e Rrezikut (RED) siguron që rreziqet operationale dhe ato të mashtrimit të adresohen sistematikisht dhe me transparencë dhe që të gjitha hapat korrigjuese apo parandaluese të dokumentohen qartë dhe të jenë të aksesueshme për kontrollin nga niveli menaxhues, si në nivel banke, ashtu edhe në nivel grupi. Punonjësve u kërkohet që të raportojnë të gjitha ngjarjet që përfaqësojnë një humbje faktike apo të mundshme prej më shumë se 100 Eurosh, duke përdorur ndërfaqen e RED. Ngjarje të raportuara që përmbajnë rreziqet më të shtira, dhe që konsiderohen si ngjarjet me më shumë gjasa për t'u përsëritur, i nënshtrohen një analize të thellë nga Komiteti i Rrezikut Operacional, i cili më vonë propozon masat e përshtatshme parandaluese.

Një aspekt kyç i menaxhimit të rrezikut është kultura e rrezikut të institucionit, e cila u përçohet të gjithë punonjësve përmes trajnimeve sistematike. Si pjesë e trajnimit të tyre fillestar, të gjithë anëtarëve të rinj të stafit u mësohet se si ta dallojnë dhe ta shmangin rrezikun operacional dhe atë të mashtrimit dhe si të ruajnë sigurinë e informacionit.

Mjaftueshmëria e Kapitalit

Mjaftueshmëria e kapitalit të bankës llogaritet çdo muaj dhe i raportohet si Drejtorisë Ekzekutive, ashtu edhe Bankës së Shqipërisë dhe Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut të Grupit, së bashku me parashikimet aktuale për të siguruar përputhshmërinë në të ardhmen me kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit.

Edhe në këtë aspekt, mbështetja e fortë e aksionerëve tanë i ka dhënë mundësi bankës që të ruajë një nivel komod kapitali. Më 30 Qershor 2013, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (kapitali i nivelit 1 dhe nivelit 2 / asetet e peshuara ndaj rrezikut) ishte në nivelin e 13.11% (Metodologjia e Bankës së Shqipërisë), mjaft lart në krahasim me standardin minimal të të gjithë grupit, që është 12% e që është në të njëjtën kohë edhe minimumi i kërkuar në vend.

Objektivat e bankës në menaxhimin e kapitalit, që është një koncept më i gjerë sesa 'equity' sa i përket bilancit, janë:

- të veprojnë në përputhje me kërkesat për kapital të vendosura nga Banka e Shqipërisë;
- të mbrojnë mundësinë e bankës për të vazhduar si një punë në proces, në mënyrë që ajo të mund të vazhdojë t'u ofrojë fitime aksionerëve dhe përfitime aktorëve të tjerë të interesuar; dhe
- të ruajë një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator monitorohen çdo ditë nga niveli menaxhues i Bankës, duke përdorur teknika të bazuara në udhëzimet e hartuara nga Komiteti i Bazelit dhe Direktivat e Komunitetit Europian, siç janë vënë në zbatim nga Banka e Shqipërisë, për qëllime mbikëqyrëse. Informacioni i kërkuar depozitohet në Bankën e Shqipërisë çdo tre muaj.

Aktivitetet e peshuara ndaj rrezikut maten përmes hierarkisë së katër peshave rreziku të klasifikuara sipas natyrës— dhe duke reflektuar një përlllogaritje të rrezikut të kredisë, tregut dhe rreziqeve të tjera që shoqërojnë— çdo aktiv dhe kundërparti, duke marrë parasysh çdo kolateral apo garanci të pranueshme. Një trajtim i ngjashëm është miratuar edhe për ekspozimin e zërave jashtë bilancit, me disa përshtatje për të reflektuar natyrën më rastësore të humbjeve të mundshme.

Banka e ka zbatuar Metodologjinë sipas Rregullores së Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për Mjaftueshmërinë e Kapitalit, miratuar me Vendimin Nr.58, datë 05.05.1999, ndryshuar së fundmi me Vendimin Nr.26, datë 27.03.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë kërkon nga çdo bankë apo Grup bankar: (a) të mbajë nivelin minimal të kapitalit rregullator prej 1 miliard lekë (b) të ruajë një raport total rregullator me asetet e peshuara ndaj rrezikut ('raporti i Bazelit') në nivelin e pranuar ndërkombëtarisht prej 12% ose më lart, dhe që Banka të veprojë në përputhje me këto kërkesa.

Kapitali rregullator i Bankës menaxhohet nga Departamenti i saj i Rrezikut dhe ndahet në dy nivele:

- 1 Kapitali i nivelit 1: kapitali aksioner (shuma neto e çdo vlere të regjistruar të aksioneve të thesarit), fitimi i mbajtur dhe rezervat e krijuara nga përvetësimet e fitimeve të mbajtura; dhe
- 2 Niveli 2 i kapitalit: kapitali i kredive të varura kualifikues, fondet kolektive të mbulimit të rrezikut dhe fitimet e përcaktuara që krijohen nga vlerësimi i drejtë i kapitalit (*equity*) dhe

instrumenteve të borxheve të mbajtura në dispozicion për shitje. Më 28 Shtator 2009, Banka ka marrë dy letra konfirmuese për kredi të varura (*subordinated promissory notes*) me vlerë prej 1.5 dhe 3.5 milion EUR, përkatësisht nga ResponsAbility SIVAC (Luksembourg) dhe nga *Credit Suisse Microfinance Fund Management Company* (Luksembourg). Data e maturimit për të dyja letrat konfirmuese për kredi të varura është 28 Shtatori 2019. Më 29 Tetor 2009, Banka ka marrë nga *DWM-SNS Institutional Microfinance Fund II*, e regjistruar në Konektikat, SHBA, një borxh të varur prej 4 milion Euro me datë maturimi 29 Tetor 2017.